BISEDË VLLAZNORE
ME AKTIVISTIN
E ÇËSHTJES KOMBËTARE SHQIPTARE

Z. HARRY BAJRAKTARI

★ ★ ★

MATERIAL I REGJISTRUAR DHE TRANSKRIPTUAR ME MIRËKUPTIMIN E Z. HARRY BAJRAKTARI

BISEDË VLLAZNORE
ME AKTIVISTIN
E ÇËSHTJES KOMBËTARE SHQIPTARE

Z. HARRY BAJRAKTARI

★ ★ ★

12 janar 2025,

NEWARK, USA

KY MATERIAL ËSHTË REGJISTRUAR
DHE TRANSKRIPTUAR ME MIRËKUPTIMIN
E Z. HARRY BAJRAKTARI

PASQYRA E LËNDËS

Një jetëshkrim i shkurtër i Harry Bajraktarit 5
Ndikimi i perandorisë osmane dhe beteja për mbijetesë 7
Roli i edukimit dhe fryma patriotike 8
Angazhimi në Amerikë dhe lobimi për çështjen shqiptare 9
Themelimi i ligës qytetareshqiptaro-amerikane 9
Lobimi në Washington dhe mbështetja për Kosovën 11
Vendosmëria e Rugovës për pavarësinë 12
Roli i Washingtonit në luftën për liri 12
Dashuria dhe mbështetja e Amerikës për shqiptarët 14
Një trashëgimi që duhet mbajtur gjallë 14
Një rrjet miqësish që bënë historinë 17
Miqësia me Jim Xhemën dhe mbështetësit e tjerë të shqiptarëve . . 18
Roli i grave në diplomacinë shqiptaro-amerikane 18
Marrëdhënia me presidentin Bill Clinton 19
Cilat janë cilësitë që kanë vlerësuar liderët amerikanë tek shqiptarët? 21
Një lidhje e veçantë me Amerikën 21
Një miqësi që duhet ruajtur 22
Lobimi i pandalshëm për Kosovën 23
Përkrahja pas luftës dhe pavarësisë së Kosovës 24
Nderimi për kongresmenin Engel 25
Njohja nga kongresi amerikan 26
Zgjedhjet presidenciale dhe afrimi me Clinton-in 29
Mbështetja për Clinton-in dhe fitorja e tij 30
Takimi me Clinton-in dhe vizita e Rugovës në Shtëpinë e Bardhë . . 31

Një miqësi e veçantë me shqiptarët 32
Lidhja e presidentit Clinton me komunitetin shqiptar
në Chappaqua 32
Presioni i padrejtë ndaj Kosovës dhe diplomacia e BE-së 40
Ndikimi global dhe pasiguria e rajonit 40
Mesazhi për liderët shqiptarë 41
Pse duhet të organizohemi më mirë? 43
Shembuj pozitivë nga komuniteti shqiptar në SHBA 44
Mesazhi im për të gjithë shqiptarët 45

NJË JETËSHKRIM I SHKURTËR I HARRY BAJRAKTARIT

Harry Bajraktari është një biznesmen, filantrop dhe aktivist politik shqiptaro-amerikan, i njohur për kontributet e tij të rëndësishme në Shtetet e Bashkuara të Amerikës në dobi të çështjes kombëtare shqiptare, kudo që ndodhen shqiptarët, në SHBA, Kosovë, Shqipëri, Preshevë e Bujanoc, Çamëri, Maqedoninë e Veriut, Mal të Zi dhe në mbarë diasporën.

Ai ka lindur në vitin 1957 në Vranoc të Pejës, në Kosovë. Familja e tij emigroi në Shtetet e Bashkuara të Amerikës në vitin 1969, në kërkim të mundësive më të mira për jetesë dhe zhvillim. Në fillim të viteve 1980, Harry Bajraktari themeloi në New York kompaninë Bajraktari Realty Management Corp., e cila do të shënonte fillimin e suksesit të tij në biznesin e pasurive të paluajtshme.

Ai është një nga nismëtarët e themelimit të Ligës Qytetare Shqiptaro-Amerikane, (AACL) bashkëthemelues dhe ish-nënkryetar i Këshillit Kombëtar Shqiptaro-Amerikan (NAAC) organizata shqiptaro-amerikane jofitimprurëse që promovojnë çështjet shqiptare në Ballkan.

Ai është gjithashtu themelues dhe botues i gazetës dygjuhëshe "Illyria" në New York, e cila ka luajtur një rol të rëndësishëm në njohjen dhe prezantimin e çështjes shqiptare përpara institucioneve amerikane.

Gjatë luftës në Kosovë, Harry Bajraktari ka lobuar me këmbëngulje te politikanë të nivelit të lartë amerikan, përfshirë presidentët Bill Clinton dhe George W. Bush, për të mbështetur ndërhyrjen ndërkombëtare kundër caqeve ushtarake në Serbi dhe për çlirimin e Kosovës, si dhe për njohjen e pavarësisë së saj. Ai ka pasur miqësi dhe bashkëpunim të ngushtë me Presidentin Ibrahim Rugova, me ish-Presidentin Sali Berisha, si dhe me thuajse të gjithë liderët politikë në Kosovë.

Ai ka pasur dhe vazhdon të ketë njohje dhe miqësi me kongresmenë dhe senatorë amerikanë, të cilët kanë qenë shumë instrumentalë në shndërrimin e çështjes shqiptare në përgjithësi, dhe veçanërisht asaj të Kosovës, në një temë dhe preokupim të Kongresit, Senatit dhe Shtëpisë së Bardhë.

Lista emërore e miqve të tij në Kongresin dhe Senatin Amerikan është e gjatë dhe kulmon me kongresmenin që tashmë njihet si mbrojtësi më i

vendosur dhe më i palëkundur i Kosovës, Eliot Engel. Falë kontributit të tij, sot ka rrugë në Kosovë që mbajnë emrin e tij: Rruga Eliot Engel.

Për kontributet e tij të jashtëzakonshme në mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve dhe në promovimin e demokracisë në Kosovë dhe Shqipëri, Harry Bajraktari është nderuar me tituj dhe dekorata të larta nga qeveritë e të dy vendeve. Ai mban dekoratën "Nderi i Kombit", akorduar nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë, si dhe është nderuar nga Presidenti i Republikës së Kosovës me mirënjohje të veçanta për mbështetjen e palëkundur ndaj çështjes së Kosovës.



Një moment i veçantë me z. Harry Bajraktari, në një nga zyrat e Kongresit Amerikan në Washington, D.C.

Në Kosovë, ai ka ndërtuar qendrën tregtare "Mete Bajraktari Plaza" në qytetin e Pejës — një investim i rëndësishëm që mban emrin e të atit të tij, si një dëshmi e lidhjes shpirtërore dhe kontributit ndaj vendlindjes.

Mal Berisha: Takimet me z. Harry Bajraktari, një patriot i lindur në Kosovë dhe i vendosur që në rininë e hershme në New York, SHBA – një aktivist i njohur i çështjes sonë kombëtare shqiptare, janë gjithmonë të një kënaqësi të veçantë. Bisedat me të janë përherë të këndshme. Ato mbartin në thelb një shqetësim të brendshëm, aspak thjesht personal, por të lidhur ngushtësisht me fatin dhe sfidat e shqiptarëve, kudo që ndodhen, brenda ose për rreth kufijve shqiptaro-shqiptarë, në Ballkanin tonë përherë të trazuar.

Kësaj here, në një bisedë të gjatë vëllazërore, u ndalëm te ajo që mund ta quaj një udhëtim të gjatë, përmes një rruge plot pengesa, por me një përfundim të lumtur, të paktën për Kosovën. Kjo bisedë ndodhi pikërisht në restorantin "SIHANA BISTRO", në Newark, New Jersey. Pikërisht në atë restorant e zhvilluam atë bisedë, e cila mori formën e një interviste, jo të marrë nga një gazetar dhe as të dhënë nga një i intervistuar në kuptimin e zakonshëm, por të një bashkëbisedimi të natyrshëm, të cilin, nga forma e saj zanore, e transkriptova në formë të shkruar, si më poshtë.

Mal Berisha: *Zoti Bajraktari, si u angazhuat në kauzën kombëtare shqiptare që në rininë tuaj?*

Harry Bajraktari: Së pari, ju falënderoj për këtë mundësi dhe për vëmendjen që i kushtoni një çështjeje kaq të rëndësishme. Historia ime është e lidhur ngushtësisht me përpjekjet shekullore të familjes sime për mbrojtjen e identitetit shqiptar. Unë vij nga një familje me rrënjë të thella patriotike, nga fshati Vranoc i Kosovës. Tradita jonë është e lidhur me rezistencën ndaj pushtuesve të ndryshëm – nga Perandoria Osmane, te Mali i Zi, Serbia dhe më pas regjimi komunist. Ashtu si shumë familje të tjera shqiptare, edhe ne kemi sakrifikuar për lirinë dhe dinjitetin kombëtar.

Origjina jonë është nga Gegëhyseni, në Malësinë e Gjakovës. Historia familjare dëshmon se kemi qenë gjithmonë pjesë e Kosovës, pasi e gjithë ajo krahinë ka qenë dhe mbetet pjesë e saj. Më shumë se 200 vjet më parë, morëm titullin e Bajraktarit, titull që e kemi mbajtur me nder dhe përgjegjësi për shekuj me radhë.

Kur të parët tanë u shpërngulën nga Gegëhyseni, ishin baba Dedë Mrripa dhe tre djemtë e tij, Sadiku, Miftari dhe Mehmeti. Ata u vendosën në fshatin Vranoc, një emër që rrjedh nga një ndodhi historike, nga një vend ku ishte vrarë Ndoci.

Xhamia e fshatit Vranoc

"Si quhet ky vend?" – pyetën ata.

"Aty ku është vrarë Ndoci," iu përgjigjën atyre. Kështu, ky toponim përjetësoi një ndodhi të rëndësishme dhe u bë simbol i qëndresës sonë.

NDIKIMI I PERANDORISË OSMANE DHE BETEJA PËR MBIJETESË

Në kushtet e rënda të sundimit osman, familja jonë, ashtu si shumë të tjera, u përball me sfida të mëdha. Dy nga vëllezërit, Sadiku dhe Miftari, u morën me forcë në ushtrinë osmane, ndërsa Mehmeti mbeti të kujdesej

për punët e shtëpisë. Një moment vendimtar për historinë e familjes tonë ishte atherë kur Mehmeti vendosi të vizitonte vëllezërit ushtarë në Maqedoni, pranë kufirit me Greqinë. Aty gjeti ushtrinë osmane të demoralizuar, ndërsa një luftëtar grek sfidonte hapur ushtarët osmanë në mejdan, por askush nuk guxonte t'i dilte përballë.

Kur Mehmeti mësoi për këtë situatë, pyeti:

"A është edhe ai një njeri si ne?"

"Po," – iu përgjigjën.

"E po, unë do të dal në duel me të."

Fjala për guximin e tij u përhap me shpejtësi. Kur pashai osman e thirri dhe i ofroi armatim të ri, Mehmeti e refuzoi, duke kërkuar të dyluftonte vetëm me pushkën e tij. Në betejën që pasoi, ai e vrau grekun dhe fitoi respektin e të gjithëve. Pas këtij akti heroik, familjes sonë iu dha titulli "Bajraktar i Vranocit dhe i Lugut të Baranit."

Ky titull e vendosi familjen tonë në qendër të rezistencës shqiptare. Kullat tona u dogjën fillimisht nga Perandoria Osmane gjatë kohës së Bajram Currit, e më pas nga forcat serbe dhe malazeze. Gjatë luftës së fundit, serbët shkatërruan pothuajse tërësisht të gjithë fshatin, duke djegur Kullën e Bajraktarit dhe atë të Syl Rexhës. Për shekuj me radhë, familja ime ka qenë e përfshirë në luftën për mbijetesë dhe dinjitet. Kur komunizmi mori pushtetin, përndjekjet vazhduan. Pas këtyre vuajtjeve, rruga jonë na çoi nga Kosova drejt Amerikës, ku gjetëm një vend që na ofroi mundësi të reja për të vazhduar betejën tonë në një formë tjetër – përmes diplomacisë dhe lobimit.

ROLI I EDUKIMIT DHE FRYMA PATRIOTIKE

Si i ri, pata fatin të takoj figura të shquara të emigracionit, si Xhafer Devën, familjen e Binak Alisë, Muslinë dhe shumë të tjerë. Kujtoj gjithashtu takimet me Abaz Kupin dhe Mehmet Agë Rashkocin. Në atë kohë, nuk kishim as televizor, madje as radio. Por edukimi ynë nuk vinte nga librat. Ai vinte nga rrëfimet e pleqve dhe këngët patriotike të gjyshit tim, i cili me

çiftelinë e tij këndonte për Binak Alinë, Mic Sokolin, Hasan Prishtinën dhe Bajram Currin. Përmes këtyre këngëve, ai na mësonte të donim atdheun dhe të mos harronim kurrë sakrificat e paraardhësve tanë.

ANGAZHIMI NË AMERIKË DHE LOBIMI PËR ÇËSHTJEN SHQIPTARE

Kur mbërritëm në Amerikë, e ndjeva për detyrë të përdorja çdo mundësi për të ndihmuar çështjen shqiptare. Kam pasur fatin të angazhohem në ndërkombëtarizimin e çështjes së Kosovës dhe të kontribuoj në forcimin e marrëdhënieve shqiptaro-amerikane. Ne kemi qenë të pranishëm në Shtëpinë e Bardhë kur Shqipëria u pranua në NATO dhe kemi mbështetur gjithashtu integrimin e Maqedonisë së Veriut dhe Malit të Zi. Sot, fokusi ynë kryesor mbetet anëtarësimi i Kosovës në NATO. Kjo nuk është vetëm puna ime, por edhe e shumë bashkëkombësve të mi, të cilët kanë dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm.

THEMELIMI I LIGËS QYTETARE SHQIPTARO-AMERIKANE

Mal Berisha: *Ju jeni një nga nismëtarët e Ligës Qytetare Shqiptaro-Amerikane, e cila u themelua për të përfaqësuar shqiptarët në SHBA dhe për të siguruar financimin e lobimit politik. Cilat janë kujtimet tuaja nga ajo kohë?*

Harry Bajraktari: Liga Qytetare Shqiptaro-Amerikane u krijua në një moment kyç, kur shqiptarët në Amerikë filluan të angazhoheshin më seriozisht në politikën amerikane. Joseph DioGuardi ishte një nga figurat kryesore në organizimin e saj, ndërsa përkrah tij qëndronin Jim Xhema, Sami Repishti, vëllezërit Bytyçi, Rexhe Cakli dhe shumë të tjerë.

Fillimisht, brenda komunitetit tonë kishte ndasi mendimesh. Disa besonin se bashkëpunimi me Shqipërinë e drejtuar nga Enver Hoxha do të ndihmonte çështjen e Kosovës, ndërsa të tjerë e kundërshtonin këtë ide. Me kalimin e kohës, shumica u bind se rruga më e sigurt ishte lobimi i drejtpërdrejtë pranë qeverisë amerikane.

Përmes Ligës, ne ndërtuam një mekanizëm të fuqishëm për mbështetjen e kauzës shqiptare në Washington, angazhim që vazhdon edhe sot.

Mal Berisha: *Zoti Bajraktari, ju keni pasur marrëdhënie shumë të afërta me Presidentin Ibrahim Rugova, lidhje që shpesh dukej se shkonin përtej politikës. Pritjet që i keni bërë në shtëpinë tuaj, udhëtimet e tij në Amerikë dhe roli juaj në ndihmën për krijimin e kontakteve të rëndësishme – cilat janë kujtimet tuaja nga ajo periudhë?*.

Harry Bajraktari: Takimi im i parë me Presidentin Rugova ndodhi në vitin 1989, kur ai erdhi në Amerikë për të marrë pjesë në përvjetorin e Pjetër Bogdanit, një ngjarje e organizuar nga Kisha Katolike. Ishte një moment i rëndësishëm, dhe biseda jonë e parë më la mbresa të thella.

Takimi u mbajt në shtëpinë e vëllezërve Bytyçi, Sergios dhe Sabitit, ku diskutuam për sfidat që kishte Kosova dhe se si mund të kontribuonim

Në fotot me Presidentin Ibrahim Rugova në Washington, D.C., gjatë fillimeve të para të vizitave të tij në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Në këtë foto historike, President Rugova ndodhet në qendër, i rrethuar nga personalitete të shquara të diasporës shqiptare dhe miq të çështjes shqiptare: Harry Bajraktari, Rexhë Xhakli, Isa Zmberi, Antony Athanas, Alush Gashi, Adnan Merivci, Shaqir Shaqiri, Sami Repishti, At Arthur Liolini, etj.

Takimet me Kongresmenin Eliot Engel janë gjithmonë të këndshme dhe frymëzuese. Ai mbetet një mik i sinqertë dhe një mbrojtës i palodhur i çështjes shqiptare në Kongresin e Shteteve të Bashkuara – ndër ata njerëz që i kanë dhënë zë dhe dinjitet kauzës sonë në arenën ndërkombëtare.
(Në foto: Erion Berisha, Kongresmeni, Harry Bajraktari)

për ta ndihmuar vendin tonë. Ishin vite të vështira, por Presidenti Rugova u bë figura qendrore në rrugëtimin e Kosovës drejt lirisë dhe pavarësisë.

E ndjej veten me fat që pata mundësinë të punoja dhe të bashkëpunoja me të. Ne e dinim se duke mbështetur Rugovën, po ndihmonim Kosovën.

LOBIMI NË WASHINGTON DHE MBËSHTETJA PËR KOSOVËN

Një nga momentet më historike ishte në vitin 1993, kur shoqërova Presidentin Rugova në vizitën e tij të parë në Shtëpinë e Bardhë. Ishim në një etapë delikate të angazhimit tonë diplomatik dhe, përmes takimeve me Sekretaren e Shtetit Madeleine Albright dhe zyrtarë të lartë amerikanë, ne po përpiqeshim të siguriminim mbështetje ndërkombëtare për Kosovën.

Gjatë atyre viteve, Rugova udhëtoi shpesh në New York dhe Washington, dhe ne si grup lobistësh bënim gjithçka që ishte e mundur për të forcuar pozitat e Kosovës në arenën ndërkombëtare. Kjo ishte një periudhë e mbushur me sfida, por e dominuar nga një vizion i qartë: Pavarësia pa kushte e Kosovës.

Në atë kohë, shumica e njerëzve nuk besonin se Kosova mund të bëhej shtet i pavarur. Madje, slogani kryesor që përdorej në vitet '90 ishte kërkesa për një Republikë brenda Jugosllavisë. Askush nuk e imagjinonte se do të arrinim kaq larg. Por Ibrahim Rugova ishte i palëkundur në qëllimin e tij dhe nuk e ndërronte asnjëherë kursin e tij strategjik.

VENDOSMËRIA E RUGOVËS PËR PAVARËSINË

Në shumë takime që kam ndjekur me të, kishte zyrtarë që e këshillonin të mos kërkonte pavarësi të plotë, por të synonte një status të veçantë brenda Bashkimit Evropian. Ata sugjeronin se Kosova mund të përfitonte më shumë nëse mbetej pjesë e një federate apo konfederate. Por ai kishte një përgjigje të qartë dhe të prerë:

"Na njihni si shtet të pavarur vetëm për 24 orë, pastaj bëhemi pjesë e Bashkimit Evropian. E rëndësishme është të kryejmë atë akt historik, dhe më pas mund të integrohemi."

Ai e kuptonte rëndësinë e diplomacisë, por gjithashtu e dinte se pa pavarësi nuk kishte stabilitet për Kosovën.

ROLI I WASHINGTONIT NË LUFTËN PËR LIRI

Unë e konsideroj veten me fat që isha pjesë e këtij rrugëtimi. Për fat të keq, babai dhe pjesa më e madhe e familjes sime nuk patën mundësinë ta përjetonin këtë moment historik, por ne e luftuam Serbinë nga Washingtoni.

Serbia nuk mund të mposhtej nga brenda Kosovës – ajo u mposht në Washington.

Aty u morën vendimet që çuan në bombardimet e NATO-s dhe në çlirimin e Kosovës. Aty ndodhi lobimi që bëri të mundur që sot 115 shtete ta njohin Kosovën si shtet të pavarur.

Ishte një udhëtim i gjatë dhe sfidues, por historia tregoi se vendosmëria

e Presidentit Rugova dhe përkushtimi i gjithë atyre që punuan, luftuan dhe e dhanë edhe jetën për çështjen shqiptare e çuan Kosovën në vendin ku është sot.

Mal Berisha: *Duke u ndalur te Presidenti Rugova, më intereson të di: A e ndjenit që në atë kohë se strategjia e tij ishte ajo që do ta çonte Kosovën drejt pavarësisë? Ai vendosi pika kyçe: ndërhyrjen ushtarake, vendosjen e administrates së përkohshme ndërkombëtare, zgjedhje të lira, shpalljen e pavarësisë dhe ndërtimin e një shteti funksional të lirë dhe demokratik.*

Besoj se vizioni i tij ishte i qartë që në fillim dhe se ju, ashtu si shumë të tjerë që e mbështetët, e kuptuat rëndësinë e rrugës që ai kishte zgjedhur. Në retrospektivë, duket se shumë pak liderë në botë kanë qenë kaq largpamës sa ai.

Sot, ne mund të udhëtojmë në Kosovë të lirë, pa pengesa e frikë. Kosova nuk sundohet më nga të huajt, por nga vetë shqiptarët.

Harry Bajraktari: Po, absolutisht! Unë besoj në Zot, dhe kohë pas kohe, Zoti i dërgon kombit njerëz që bëjnë histori. Presidenti Rugova ishte një prej tyre. Rruga e tij ishte një mision i shenjtë, një përkushtim që nuk lëkundej përballë asnjë sfide. Historia jonë ka njohur njerëz të jashtëzakonshëm që në momentet vendimtare I kanë dalë zot vatanit. Skënderbeu ishte një i tillë. Nënë Tereza ishte një tjetër. Presidenti Rugova, me vizionin dhe durimin e tij, e udhëhoqi Kosovën drejt çlirimit dhe pavarësisë.

Nëse kthehemi pas në kohë dhe analizojmë rrethanat, arritja e pavarësisë brenda një periudhe kaq të shkurtër është e pabesueshme. Nga viti 1989 deri në vitin 1999, Kosova u çlirua. Vetëm 18 vjet më vonë, në 2008, ajo u shpall shtet i pavarur.

E gjitha kjo u realizua pa një ushtri të organizuar, pa burime financiare dhe pa një mbështetje të qartë ndërkombëtare në fillim. Por Rugova kishte një strategji të qartë, e cila përfshinte ndërtimin e një fronti diplomatik të fortë dhe krijimin e një aleance të palëkundur me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

DASHURIA DHE MBËSHTETJA E AMERIKËS PËR SHQIPTARËT

Për fat të mirë, shqiptarët kanë pasur gjithmonë një lidhje të veçantë me Amerikën. Kjo miqësi nuk filloi dje – ajo ka rrënjë të thella historike. Presidenti Woodrow Wilson e mbrojti Shqipërinë në Konferencën e Paqes në Versajë dhe pengoi copëtimin e saj të mëtejshëm.

Një tjetër fakt interesant është se babai i ambasadorit Frank Wisner, një nga arkitektët e CIA-s, punoi me shqiptarët në Gjermani gjatë Luftës së Ftohtë për të rrëzuar regjimin komunist në Shqipëri. Kjo dëshmon për angazhimin historik të SHBA-ve ndaj çështjes shqiptare. Në vitet e fundit të shekullit XX, kjo mbështetje u materializua përmes personaliteteve të jashtëzakonshme si:

- Senatori Bob Dole, një mik i madh i shqiptarëve, i cili bashkëpunoi ngushtë me Jim Xhemën dhe komunitetin shqiptaro-amerikan.
- Kongresmeni Tom Lantos, i cili mbështeti fuqishëm Kosovën, veçanërisht duke vlerësuar rolin e shqiptarëve në shpëtimin e hebrenjve gjatë Luftës së Dytë Botërore.
- Madeleine Albright dhe Eliot Engel, dy figura kyçe që ndihmuan në ndërhyrjen e NATO-s dhe mbrojtjen e Kosovës nga gjenocidi serb.

Kjo marrëdhënie mes shqiptarëve dhe Amerikës nuk është rastësi, por një kapital politik dhe historik, të cilin duhet ta ruajmë dhe ta forcojmë vazhdimisht.

NJË TRASHËGIMI QË DUHET MBAJTUR GJALLË

Ne si komunitet kemi punuar shumë për ta ndërtuar këtë miqësi dhe jemi me fat që e kemi arritur deri këtu. Por sfida nuk ka përfunduar – është detyra jonë që këtë trashëgimi politike dhe diplomatike ta zhvillojmë më tej, për të siguruar një të ardhme edhe më të ndritur për shqiptarët kudo që janë.

Mal Berisha: *Zoti Bajraktari, nga gjithçka që thatë deri tani, vizioni i Presidentit Rugova mund të dukej si një utopi, por në realitet nuk doli*

Në foto: Z. Harry Bajraktari, bashkë me zonjën e tij Liza, në qendër ndodhet Prof. Dr. Jonathan Brent, drejtor i YIVO Institute for Jewish Research në New York, Donika Berisha dhe Mal Berisha në ditën e prezantimit të punimit: “Besa shqiptare” që ruajti jetën e qindra hebrenjve në Shqipëri.



Në foto me Kongresmenin amerikan Eliot Engel.

e tillë. Shumë e konsideronin ëndërrimtar, madje idealist, por faktet treguan të kundërtën. Jugosllavia ishte një fuqi e konsiderueshme në atë kohë, një vend i respektuar nga Perëndimi dhe udhëheqës i Lëvizjes së të Pa-angazhuarve, ku bënin pjesë rreth 90 shtete të botës. Titoja, me gjithë politikën e tij shtypëse ndaj shqiptarëve, kishte lënë një trashëgimi të fortë ndërkombëtare.

Megjithatë, Presidenti Rugova arriti të ndryshonte rrjedhën e historisë, dhe jo vetëm që e ëndërroi një Kosovë të lirë, por e pa edhe realizimin e saj në të gjallë të tij. Ju përmendët më herët emra të rëndësishëm si Tom Lantos, Eliot Engel dhe Madeleine Albright, personalitete që patën një ndikim vendimtar në çështjen e Kosovës. Me cilin prej tyre keni pasur marrëdhënien më të afërt dhe si ndodhi bashkëpunimi juaj me ta?

Harry Bajraktari: Takimet dhe angazhimi ynë me këto figura të mëdha filluan në fund të viteve ’80 dhe fillim të viteve ’90. Për herë të parë e



Një moment i paharruar në Vatikan, më 5 shtator 2016, së bashku me Kongresmenin Eliot Engel, gjatë ceremonive madhështore të shenjtërimit të Nënë Terezës. Në një atmosferë të mbushur me emocione dhe devotshmëri, në praninë e mijëra pelegrinëve nga e gjithë bota, Papa Françesku shpalli shenjtore bijën më të ndritur të kombit shqiptar – simbolin e dashurisë dhe përkushtimit ndaj më të varfërve të kësaj bote. Ky ishte një çast krenarie dhe nderimi jo vetëm për shqiptarët, por për mbarë njerëzimin.

takova kongresmenin Tom Lantos në vitin 1990, së bashku me Jim Xhemën dhe Joseph DioGuardin, i cili në atë kohë ishte kongresmen. Po atë vit, njoha edhe Eliot Engel, sapo ishte zgjedhur për herë të parë në Kongresin Amerikan.

Zyra e tij ndodhej në Bronx, afër selisë sonë. Kur e vizitova për ta uruar për fitoren, i tregova për situatën në Kosovë dhe për shqetësimet e komunitetit shqiptar. Ai më dëgjoi me shumë vëmendje dhe më tha diçka që më mbeti në mendje:

> *"Nuk di shumë për shqiptarët, por dua të mësoj. E shoh se nëse është dikush që mund të më edukojë, ai jeni ju."*

Që nga ai moment, nisëm një marrëdhënie të fortë, e cila vazhdoi për mbi tridhjetë vjet. Eliot Engel u bë një avokat i palodhur i çështjes shqiptare dhe një mik i ngushtë i familjes sime.

Në vitet '90 pata fatin të takoja edhe senatorin Bob Dole, një prej figurave më të rëndësishme që i ka mbështetur shqiptarët. Ai ishte herë lider i shumicës dhe herë i pakicës në Senatin Amerikan, dhe, pavarësisht nëse ishte në opozitë apo në pushtet, ai nuk ndaloi kurrë së mbështeturi Kosovën. Ishte një personalitet i jashtëzakonshëm.

NJË RRJET MIQËSISH QË BËNË HISTORINË

Në zyrën e senatorit Dole punonte zonja Mira Ricardel, një grua me origjinë kroate, e cila për tridhjetë vjet u angazhua për kauzën tonë. Ajo ishte një nga figurat kyçe pas skenave, duke lobuar për shqiptarët në qarqet më të larta të politikës amerikane. Në shenjë mirënjohjeje, Presidenca e Kosovës e dekoroi me Medalje Ari, në Washington.

Kur Presidenti Rugova ose liderë të tjerë shqiptarë vizitonin Washingtonin, zyrat e senatorit Dole dhe kongresmenit Engel ishin si selitë tona. Aty organizonim takime, përdornim telefonat e tyre për të kontaktuar Departamentin e Shtetit dhe Shtëpinë e Bardhë, koordinonim çdo lëvizje dhe strategji. Ishte një mbështetje e jashtëzakonshme që tregonte besimin e madh që kishin ndaj nesh.

MIQËSIA ME JIM XHEMËN DHE MBËSHTETËSIT E TJERË TË SHQIPTARËVE

Një tjetër figurë e jashtëzakonshme ishte Jim Xhema, një njeri i jashtëzakonshëm që luajti një rol kyç në ndërtimin e lidhjeve shqiptaro-amerikane. Nuk ishim vetëm – shumë njerëz dhanë kontributin e tyre.

Ndër figurat që na mbështetën ishte edhe kongresmeni Broomfield nga Michigan dhe Sue Kelly, një republikane nga Westchester, e cila shërbeu si kryetare e Grupit të Miqësisë Amerikë – Shqipëri në Kongres. Ajo kishte një dashuri të veçantë për shqiptarët dhe bashkëpunimi me të ishte i jashtëzakonshëm.

Një moment i paharrueshëm ishte udhëtimi i vitit 1999 në Rambuje, ku ne shkuam së bashku me kongresmenin Eliot Engel. Për të bindur Sue Kelly të na bashkohej, e ftova me humor:

"Zonjë kongresmene, po ju ftoj të kaloni Shën Valentinin në Paris!"

Ajo u habit dhe më pyeti se çfarë kisha ndër mend? I tregova se po shkonim në Konferencën e Rambujesë, një ngjarje vendimtare për të ardhmen e Kosovës. Pas një ore, më telefonoi dhe më tha: "Po vij!".

ROLI I GRAVE NË DIPLOMACINË SHQIPTARO-AMERIKANE

Ndër gratë që dhanë një kontribut të madh ishte edhe Susan Molinari, e cila u bë bashkë-kryetare e Grupit të Miqësisë Amerikë – Shqipëri në Kongres. Ajo ishte një politikane e fuqishme republikane nga Staten Island dhe në vitin 1993, ajo vizitoi Kosovën së bashku me Eliot Engel dhe bashkëshortin e saj.

Madeleine Albright, një nga figurat më të rëndësishme në mbështetjen për Kosovën, ka thënë shpesh se shqiptarët nuk e harrojnë kurrë një mik dhe janë gjithmonë të gatshëm të ndihmojnë njëri-tjetrin.

MARRËDHËNIA ME PRESIDENTIN BILL CLINTON

Pa Presidentin Bill Clinton, historia do të kishte qenë ndryshe. Ai e mori vendimin për ndërhyrjen e NATO-s, i cili shpëtoi qindra mijëra jetë dhe i dha Kosovës rrugën drejt lirisë.

Nëse dëshironi, mund të flasim më në detaje edhe për rolin e tij dhe marrëdhënien tonë me të. Ai ishte një president i madh, dhe shqiptarët e kanë vlerësuar gjithmonë kontributin e tij historik.

Mal Berisha: *Zoti Bajraktari, prej vitesh ju njoh jo vetëm si një nga botuesit dhe mbështetësit kryesorë të gazetës ILLYRIA, por edhe si një nga figurat më të spikatura të çështjes shqiptare. Megjithatë, ndryshe nga shumë të tjerë, nuk mbaj mend që të keni mbajtur ndonjë post zyrtar apo të keni përdorur një kartëvizitë që ju prezanton si drejtues i një organizate apo shoqate. E megjithatë, pa ndonjë titull formal, ju keni ndërtuar dhe ruajtur një figurë të jashtëzakonshme si aktivist, duke gëzuar respektin e gjerë të shqiptarëve dhe miqve të tyre në Amerikë. Unë vetë, sa herë që flas për ju në shtyp apo në forume publike, ju referohem si "aktivisti i madh i çështjes sonë kombëtare shqiptare".*

Si e keni menaxhuar këtë angazhim të gjatë, duke kontribuar kaq shumë për çështjen tonë kombëtare, por pa e ekspozuar veten në qendër të vëmendjes, siç bëjnë shpesh disa drejtues shoqatash? Natyrisht, të gjithë ata që punojnë për çështjen shqiptare meritojnë respekt, por shpesh duket se disa janë më të prirur të promovojnë veten sesa vetë kauzën.



MAKING THE CASE FOR
KOSOVA AS YUGOSLAVIA COMES APART

No matter how crucial that first meeting remains in his memory, Engel's engagement with Kosova did not begin right away.

For almost a year, his contribution was not so different from that of a dozen of other Congress members. It was his senior colleague, Tom Lantos, who had taken the leadership on this issue. Lantos was introduced early to the cause of Kosova by a former congressman Joseph DioGuardi. In 1990, they both traveled to Albania and Kosova, and had introduced resolutions and made statements about the region. Coincidentally DioGuardi lost his seat on the same day that Engel won his. A search on the Congressional Records would show Engel and others supporting Lantos' work by signing up as cosponsors of resolutions or statements related to Yugoslavia or Kosova.

The slow start is understandable. A first-term congressman, Engel was still learning how Washington functioned. He was exploring a variety of issues in international affairs while trying to educate himself about the Balkans, Middle East, and other topics of interest. He had yet to become the notable and skilled legislator, blessed

Harry Bajraktari, posing with an early issue of Illyria newspaper.

Dhe një pyetje e dytë: Ju përmendët më herët emra si Madeleine Albright, Benjamin Gilman, Eliot Engel, Tom Lantos, Sue Kelly, Peter King, Susan Molinari, Bob Dole dhe shumë të tjerë.

Çfarë i ka tërhequr këta personalitete te shqiptarët? Kam dëgjuar shpesh se ata kanë identifikuar një vlerë të veçantë tek ne – familjen. Në një kohë kur në botën moderne familja ka pësuar tronditje dhe sfida, shqiptarët kanë ruajtur një unitet të fortë mes brezave – prindërve, fëmijëve, të afërmve.

Cilat mendoni se janë ato cilësi specifike që këta liderë kanë vënë re tek shqiptarët dhe që ju vetë i keni ndjerë gjatë gjithë angazhimit tuaj?

Por, së pari, dua përgjigjen për çështjen e aktivizimit tuaj.

Harry Bajraktari: Unë gjithmonë kam besuar se puna flet më shumë se titujt. Nuk më ka tërhequr asnjëherë ideja e posteve zyrtare, as nevoja për të pasur një kartëvizitë me tituj. Ajo që më ka shtyrë përpara ka qenë ndjenja e detyrës ndaj kombit tim dhe bindja se duhet të bëjmë gjithçka që mundemi për të ndihmuar njëri-tjetrin.

Shpesh shoh njerëz që, sapo marrin një pozicion formal, e përdorin atë si një mjet për të dalë në pah, për t'u vetëlavdëruar, apo për të ndërtuar një imazh personal. Kjo nuk ka qenë kurrë rruga ime. Unë nuk kam punuar për të pasur emrin tim në krye të ndonjë organizate, por për të ndihmuar komunitetin dhe kombin tim.

Ka pasur raste kur njerëzit më kanë pyetur: "Pse nuk krijoni një organizatë tuajën? Pse nuk drejtoni një shoqatë?"

Por unë gjithmonë kam menduar se e rëndësishme nuk është kush është lideri, por çfarë arrihet realisht. Në fund të fundit, historia do të mbajë mend veprat, jo kartëvizitat.

E di që shumë nga miqtë e mi kanë marrë drejtimin e shoqatave të ndryshme dhe ata meritojnë respekt për angazhimin e tyre. Por, për mua, më e rëndësishme ka qenë të punoj fort për të krijuar ura bashkëpunimi, të ndihmoj atje ku mundem, pa pritur asgjë në këmbim. Dhe jam i lumtur që e kam bërë këtë.

CILAT JANË CILËSITË QË KANË VLERËSUAR LIDERËT AMERIKANË TEK SHQIPTARËT?

Sa i përket pyetjes suaj për personalitetet e mëdha amerikane dhe çfarë kanë parë ata tek shqiptarët, mendoj se përgjigja është e thjeshtë: Shqiptarët janë një komb me vlera të rralla dhe me një ndjenjë të fortë të familjes dhe Besës.

Eliot Engel, Tom Lantos, Madeleine Albright, Bob Dole dhe shumë të tjerë e kanë theksuar gjithmonë se një nga gjërat që i ka bërë ata të lidhen me shqiptarët është uniteti familjar dhe mikpritja e jashtëzakonshme. Në një kohë kur në botën moderne familja po dobësohet, shqiptarët kanë ruajtur respektin për prindërit, lidhjet mes brezave dhe besën.

Një tjetër figurë madhore ishte Benjamin Gilman, një gentleman i vërtetë, i cili u përfshi fuqishëm në mbështetjen për Kosovën. Ai punoi pa u lodhur për ta ngritur zërin tonë në Kongresin Amerikan.

Tom Lantos ka vlerësuar faktin se shqiptarët, megjithëse kanë kaluar sfida të mëdha, kanë ruajtur dinjitetin dhe karakterin e tyre.

Bob Dole e përmendte shpesh mikpritjen shqiptare. Ai ishte i habitur nga mënyra se si shqiptarët e trajtonin atë kur vizitonte komunitetin tonë, si një mik të ngushtë, jo si një politikan. Ai thoshte se rrallë kishte parë një popull kaq të përkushtuar ndaj miqve dhe ndaj idealeve të tij.

NJË LIDHJE E VEÇANTË ME AMERIKËN

Mendoj se një tjetër arsye pse shqiptarët kanë krijuar një miqësi të fortë me Amerikën është se ne gjithmonë kemi qenë një popull pro-perëndimor, i etur për liri dhe demokraci.

Gjatë Luftës së Dytë Botërore, shqiptarët i shpëtuan hebrenjtë, duke e rrezikuar jetën e tyre për të mbrojtur të huajt. Kjo ishte diçka që Tom Lantos, një hebre që mbijetoi Holokaustin, e kishte shumë për zemër. Ai e ka përmendur disa herë në Kongres se shqiptarët janë një shembull i rrallë i njerëzores në kohë lufte.

NJË MIQËSI QË DUHET RUAJTUR

Të gjitha këto cilësi – familja, mikpritja, Besa, dinjiteti, përkushtimi ndaj lirisë – kanë bërë që shqiptarët të fitojnë respektin e liderëve amerikanë. Dhe ne kemi përgjegjësinë që këtë miqësi ta mbajmë dhe ta forcojmë.

Ashtu si e kemi ndërtuar këtë marrëdhënie me shumë mund, duhet të punojmë çdo ditë që ajo të vazhdojë dhe të bëhet edhe më e fortë.

Foto me Kongresmenin Eliot Engel, në memorialin e Skënderbeut në Lezhë, më 1 shtator 2016 – ditën kur ai u shpall "Qytetar Nderi i Lezhës" nga Këshilli Bashkiak i rrethit. Pas kësaj ceremonie, Kongresmeni u nderua nga miqtë e tij në Valbonë. Në foto: Kongresmeni së bashku me mikun e përbashkët, z. Avni Ponari.

Mal Berisha: *Zotëri Bajraktari, unë kam qenë dëshmitar i rrugëtimit të shqiptarëve në Amerikë që nga vitet 1995, 1997, 1998 e këndej. Po ashtu, kam ndjekur nga afër miqësinë tuaj të ngushtë dhe të qëndrueshme me kongresmenin Eliot Engel, një mik i madh i kombit shqiptar. Jam krenar që isha i pranishëm kur ai mori titullin "Qytetar Nderi" i Qytetit të Lezhës, në memorialin e Gjergj Kastriotit – Skënderbeut. Po ashtu, kujtoj me kënaqësi momentin kur, së bashku me ju, inauguruam Rrugën Eliot Engel, e cila lidh Ponashecin me Malësinë e Gjakovës. Një tjetër kujtim i paharrueshëm është vizita jonë e përbashkët në Valbonë.*

Dëshiroj të di: Cili është kontributi specifik dhe i drejtpërdrejtë i kongresmenit Engel në çështjen e Kosovës?

Harry Bajraktari: Kongresmeni Eliot Engel u bë një zë i fuqishëm dhe një mik i madh i shqiptarëve, duke zhvilluar një dashuri të veçantë për popullin tonë, veçanërisht për Kosovën. Ai nuk e konsideronte mbështetjen e tij si thjesht një detyrë politike, por e ndiente lidhjen me shqiptarët në mënyrë personale dhe të sinqertë.

Në fillim të viteve ’90, ai e vizitoi Kosovën shpesh, duke ndjekur nga afër zhvillimet dhe duke qëndruar pranë popullit të saj. Dua të përmend veçanërisht vizitat e tij në vitet 1993, 1994 dhe 1995, kur Kosova ishte ende nën shtypjen brutale të regjimit serb.

Një moment historik ishte viti 1995, kur në Kosovë u hap zyra e parë përfaqësuese e SHBA-ve dhe për herë të parë u valëvit flamuri amerikan në tokën e Kosovës. Presidenti Rugova ishte i pranishëm në atë ngjarje të madhe, dhe edhe Engel ishte aty, duke i dhënë mesazhin botës se Kosova kishte mbështetjen e Amerikës.

LOBIMI I PANDALSHËM PËR KOSOVËN

Angazhimi i tij nuk ishte vetëm simbolik. Në Washington, Engel u bë zëri një zë i fuqishëm i Kosovës. Kurdoherë që flitej për Kosovën në Kongresin Amerikan, pyetja që shtrohej ishte: “A e jeni konsultuar me kongresmenin Engel?”.

Në vitin 1995, ai mbështeti fuqishëm hapjen e zyrës së SHBA-ve në

Prishtinë, dhe në 1996, ai ndoqi me vëmendje procesin e votimeve në Kosovë.

Por ai nuk e ndali kurrë përpjekjen e tij, edhe kur u përball me pengesa nga regjimi serb. Në një rast, autoritetet serbe nuk e lejuan të hynte në Kosovë. Në vend që të tërhiqej, Engel udhëtoi drejt Maqedonisë së Veriut, ku, në kufirin e Hanit të Elezit, doli para gazetarëve dhe deklaroi:

> *"Milosheviçi nuk po na lejon të futemi në Kosovë, por do të vijë dita kur ne nuk do ta lejojmë Milosheviçin të hyjë në Kosovë."*

Dhe ashtu ndodhi. Dy vite më vonë, situata ndryshoi rrënjësisht.

Kongresmeni Eliot Engel naltëson Flamurin Amerikan — Flamurin e Shpresës, në Prishtinë, më 20 korrik 1996.

PËRKRAHJA PAS LUFTËS DHE PAVARËSISË SË KOSOVËS

Pas luftës së vitit 1999, Engel u kthye menjëherë në Kosovë dhe nuk e ndërpreu asnjëherë mbështetjen e tij. Ai ishte një nga të parët që punoi për ta vendosur Kosovën në agjendën ndërkombëtare, dhe pas shpalljes së pavarësisë në vitin 2008, ai vazhdoi ta vizitonte Kosovën rregullisht.

Megjithatë, atij i ngeli një peng: Engel nuk ishte i pranishëm në ditën historike të shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Ky ishte një gabim i liderëve të asaj kohe në Kosovë, të cilët nuk e ftuan zyrtarisht në atë ngjarje madhore. Ne u përpoqëm t'i bindnim autoritetet që ai duhej të ishte atje, por për fat të keq, mungoi përgjegjësia e duhur.

Por pavarësisht këtij episodi, Engel mbeti i përkushtuar ndaj Kosovës. Ai ishte një nga mbështetësit kryesorë të referendumit të organizuar nga Presidenti Rugova, dhe kur Rugova ndërroi jetë, ai e përshkroi atë moment si një referendum tjetër për pavarësinë e Kosovës.

NDERIMI PËR KONGRESMENIN ENGEL

Dashuria e tij për popullin shqiptar nuk ishte thjesht politike – ajo ishte e sinqertë dhe e përjetshme. Edhe sot, kur flas me të, ai më falënderon nga zemra që pati privilegjin të ishte pjesë e udhëtimit historik të Kosovës.

Edhe për mua ishte një nder i madh kur një nga rrugët kryesore në Pejë mori emrin e tij. Një tjetër vlerësim i rëndësishëm ishte ai i Besnik Dushajt, kryetarit të Bashkisë së Bajram Currit në atë kohë, dhe Ardian Gjinit, kryetarit të Komunës së Gjakovës, të cilët na nderuan me respekt të veçantë.

Në nderim të kontributit të tij të çmuar për çështjen e Kosovës, rruga që shtrihet nga Punasheci i Gjakovës deri në Tropojë tashmë mban emrin "Eliot Engel." Ky është momenti kur ai pranon këtë nderim nga dy bashkitë – ajo e Gjakovës dhe ajo e Tropojës – në të dy anët e kufirit shqiptar-shqiptar.

Simbolika e Rrugës "Eliot Engel", e cila bashkon dy territore shqiptare të ndara për 70 vjet, është një shembull madhështor i miqësisë shqiptaro-amerikane.

Veçanërisht e paharrueshme mbetet pritja në Bajram Curri dhe Malësinë e Gjakovës në vitin 2019. Aty u organizua një ceremoni me 400-500 pjesëmarrës, ku ndodhi një moment i veçantë: në fillim të ceremonisë nisi një shi i madh, por sapo kongresmeni Engel mori fjalën, shiu ndaloi. Ishte një çast simbolik, i cili do të mbetet gjithmonë në kujtesën time.

Në atë ngjarje të veçantë ishte i pranishëm edhe Presidenti Ilir Meta, dhe ceremonia ishte një dëshmi e mirënjohjes që komuniteti shqiptar kishte për Engel dhe për mbështetjen e tij të palëkundur.

NJOHJA NGA KONGRESI AMERIKAN

Në vitin 2017, gjatë një vizite në Washington, patëm rastin të takonim Nancy Pelosi, Kryetaren e Kongresit Amerikan. Ajo e dinte mirë se sa shumë kishte bërë Engel për Kosovën dhe, gjatë takimit tonë, u shpreh:

> *"Falënderoj zotin Bajraktari për kujdesin dhe respektin që populli i Kosovës dhe komuniteti juaj kanë treguar ndaj kongresmenit Engel."*

Takim vëllazëror me z. Harry Bajraktari – figurë emblematike e komunitetit shqiptaro-amerikan – në shoqërinë e z. Rrustem Geci, patriot dhe kontribuues i njohur nga Kosova, si dhe me Erionin, Kreshnikun dhe Mal Berishën.

Ajo ishte e informuar për të gjitha nderimet dhe mirënjohjen që ne i kishim shprehur Engelit dhe, në të njëjtën kohë, ajo falënderoi edhe vetë Engel për punën e tij të jashtëzakonshme për Kosovën.

Mal Berisha: *Në njëfarë mënyre, kongresmeni Eliot Engel është bërë tashmë pjesë e historisë sonë kombëtare. Çdo herë që kaloj kufirin nga Gjakova për në Tropojë dhe anasjelltas, më rikthehen në mendje momentet e veçanta të asaj dite kur inauguruam Rrugën "Eliot Engel" dhe koncertin festiv që u mbajt në atë rast. Kur kaloj piken kufitare në Qafën e Morinës, gjithmonë më kthehet në mendje fëmijëria ime. Kam qenë fëmijë me pasion për recitimin, dhe bashkë me dy shokët e mi – të cilët, fatkeqësisht, nuk jetojnë më – ishim pjesë e një grupi të quajtur Brigada Kulturore. Si nxënës të dalluar të shkollave të Malësisë së Gjakovës, na mblodhën dhe na dërguan fshat më fshat për të performuar. Një nga momentet më të paharrueshme ishte shfaqja jonë në pikën kufitare të Qafës së Morinës.*

Në atë kohë, frika nga Jugosllavia ishte e madhe. Ushtarët jugosllavë ishin përballë nesh, në pikat e tyre të vrojtimit, duke na vëzhguar me kujdes. Ne, fëmijët e vegjël që recitonim, i shikonim ata me ndrojtje, të mbushur me frikën e kohës.

Kur më vonë, shumë dekada më pas, u riktheva në të njëjtën pikë kufitare me kongresmenin Engel, m'u rikthye e gjithë ajo ndjenjë e fëmijërisë. Ishte një përjetim që më preku thellë – nga frika e dikurshme, tek ndjenja e krenarisë për rrugën që kishim bërë si komb i lirë edhe pse ende në dy shtete të pavarura!?

Harry Bajraktari: Është e vërtetë që ndryshimet që kanë ndodhur pas rënies së Jugosllavisë, rënies së komunizmit në Shqipëri dhe çlirimit e pavarësimit të Kosovës, kanë bërë që edhe bota jonë shqiptare të ndryshojë në mënyrë kuptimplotë.

Mal Berisha: *Zoti Bajraktari, studiuesi i njohur i historisë së shqiptarëve dhe zbuluesi i shumë dokumenteve të rëndësishme historike, Bejtullah Destani, ka përgatitur një libër në anglisht dhe në shqip mbi përfshirjen e Presidentit Bill Clinton në çështjen e Kosovës. Në këtë libër përmblidhet gjithë korrespondenca dhe përpjekjet e Clintonit për zgjidhjen e krizës*

së Kosovës, një angazhim që rezultoi në atë që sot është një Kosovë e lirë, demokratike dhe e pavarur.

Siç e përmenda edhe më parë, ju keni pasur një rrugëtim të përbashkët me aktivistët shqiptarë dhe figurat më të mëdha të politikës amerikane, të cilat kanë luajtur një rol përcaktues në fatin e Kosovës. Një ndër këta liderë historikë ishte Presidenti Bill Clinton, njeriu që drejtoi Shtetet e Bashkuara në momentin më kritik kur çështja e Kosovës kërkonte zgjidhje. Si ndodhi që ju ndërtuat një lidhje me këtë personalitet kaq të rëndësishëm të politikës botërore?

Harry Bajraktari: Është e vërtetë që komuniteti shqiptar në Amerikë ka qenë i angazhuar fuqishëm në ndihmën për Kosovën dhe Shqipërinë. Në

Në shenjë mirënjohjeje për kontributin e tij të jashtëzakonshëm në çështjen kombëtare dhe përkushtimin e pandërprerë ndaj çështjeve me interes mbarëkombëtar, sot në qytetin e Bajram Currit, në rrethin e Tropojës, një nga rrugët kryesore mban emrin e z. Harry Bajraktari.

vitin 1991, së bashku me dajën tim Rrustem Geci, themeluam gazetën ILLYRIA. Në atë kohë, informacioni për zhvillimet në Ballkan mungonte pothuajse plotësisht. Shqiptarët në Amerikë nuk kishin qasje në lajme të sakta dhe të besueshme për atë që po ndodhte në trojet tona. Po ashtu, çështja shqiptare nuk ishte e njohur në Washington. Qëllimi ynë ishte i qartë:

- Të krijonim një sistem informativ që të pasqyronte të vërtetën për shqiptarët.
- Të kishim korrespondentë në trojet shqiptare për të raportuar zhvillimet.
- Të botohej gazeta në dy gjuhë – anglisht dhe shqip, dy herë në javë.



Foto e z. Harry Bajraktari me mikun e madh të shqiptarëve, Sir Noel Malcolm, pas prezantimit të filmit dokumentar "Shqiptariada" të Sir Noel Malcolm-it – episodi i dytë: Kosova – Një histori e shkurtër – në Konsullatën e Përgjithshme të Kosovës në New York.
Z. Bajraktari i dhuron Sir Noel Malcolm-it librin: "One Life Between Kosovo and America".

ZGJEDHJET PRESIDENCIALE DHE AFRIMI ME CLINTONIN

Në vitin 1991, administrata e Presidentit George H.W. Bush po përgatitej për zgjedhjet presidenciale. Njëkohësisht, Partia Demokratike po kërkonte kandidatin e saj për zgjedhjet e vitit 1992. Në këtë periudhë, ne po kërkonim miq dhe aleatë në Kongresin Amerikan. Takimet e para i kishim me kongresmenin Tom Lantos dhe Eliot Engel, por gjithashtu ndërtuam lidhje të forta me zyrën e senatorit Bob Dole, i cili ishte një mbështetës i madh i shqiptarëve.

Në këtë kohë, Bill Clinton po fitonte terren si kandidati kryesor i Partisë

Kongresmeni Eliot Engel ka qenë dhe mbetet (edhe pse i pensionuar) mik i madh dhe i dashur i dr. Sali Berishës.

Kongresmeni Eliot Engel, dr. Sali Berisha dhe Harry Bajraktari, gjatë një prej takimeve të tyre të shumta në të dy anët e oqeanit.

Demokratike për President. Ne e kuptuam se Clinton kishte potencialin për të fituar, ndaj filluam të krijonim kontakte me ekipin e tij.

Një ndër njerëzit që na ndihmoi shumë ishte Christopher Highland. Me atë zotëri na njohën vëllezërit Sergio dhe Sabit Bytyçi. Z Higland kishte lidhje të ngushta me demokratët. Në takimet tona me komunitetin shqiptar, u vendos që unë të drejtoja përpjekjet për të krijuar lidhje me ekipin e Clintonit.

Gazeta ILLYRIA u bë një platformë e fuqishme për të përhapur mesazhin tonë.

MBËSHTETJA PËR CLINTONIN DHE FITORJA E TIJ

Një nga këshillat që morëm në atë kohë ishte nga senatori Bob Dole. Edhe pse ai ishte republikan, ai u kishte thënë njerëzve të tij:

> *"Nëse doni të ndihmoni shqiptarët, duhet të përqendroheni te kandidati demokrat, Bill Clinton."*

Ai e dinte se Clinton kishte shanse të larta për të fituar dhe se ai do të ishte një president më i hapur ndaj çështjes së Kosovës. Një faktor tjetër i rëndësishëm ishte Ross Perot, kandidati i tretë në zgjedhje, i cili ndihmoi indirekt Clintonin duke ndarë votat dhe duke ulur shanset e Bushit për të fituar. Me mbështetjen tonë, Clinton fitoi zgjedhjet presidenciale dhe ne patëm mundësinë të ishim pjesë e inaugurimit të tij në Washington. Në një darkë të organizuar nga ekipi i Clintonit pas zgjedhjeve, në Little Rock, unë isha i ftuar personalisht, si përfaqësues i komunitetit shqiptar.

TAKIMI ME CLINTONIN DHE VIZITA E RUGOVËS NË SHTËPINË E BARDHË

Pasi Clinton mori detyrën si President, ne shfrytëzuam lidhjet tona për të organizuar takimin historik të Presidentit Ibrahim Rugova në Shtëpinë e Bardhë në vitin 1993.

Rugova u prit nga Sandy Berger, Këshilltari për Sigurinë Kombëtare i Clintonit, dhe bisedimet zgjatën rreth një orë e gjysmë. Në këtë takim, isha me Presidentin Rugova dhe Dr. Alush Gashin. Ky ishte takimi i parë i një lideri kosovar me administratën amerikane, që përbën një moment historik për Kosovën. Kjo marrëdhënie vazhdoi të forcohej gjatë gjithë presidencës së Clintonit, deri në vitin 1998, kur ai ndërmori hapin vendimtar për ndërhyrjen e NATO-s në Kosovë.

Mal Berisha: *Sa i përket Kosovës, është e padiskutueshme se Presidenti Bill Clinton luajti rolin vendimtar në ngjarjet që sollën çlirimin e saj. Ai jo vetëm që drejtoi përpjekjet ndërkombëtare për të ndalur agresionin serb, por pas luftës vizitoi Kosovën dhe u prit me madhështi nga populli shqiptar. Unë pata fatin të jem aty, dhe ishte një moment i jashtëzakonshëm. Por ajo që më ka bërë gjithmonë përshtypje është lidhja e tij e veçantë me shqiptarët. Përtej rolit si President i SHBA-së, Clinton ka një dimension thellësisht njerëzor në marrëdhënien e tij me popullin shqiptar. Si e shihni ju këtë raport të tij me shqiptarët? Çfarë e bëri atë kaq të afërt me kauzën tonë? Nëse nuk gaboj, kur Presidenti Bill Clinton vendosi të vendosej në një fshat të quajtur Chappaqua, ai ndoqi një traditë amerikane sipas së cilës, përpara se të blesh një shtëpi, duhet të marrësh njëfarë konsensusi nga fqinjët. Natyrisht, kush nuk do të dëshironte të kishte një president si fqinj? Por, në rastin e tij, më duket se fqinji i tij i parë është një familje shqiptare. A është e vërtetë?*

Harry Bajraktari: Po, është plotësisht e vërtetë. Fqinji i parë i Presidentit Clinton është Osman Osmani, nga Qafa e Morinës, një mik i yni i afërt. Motra ime është e martuar me vëllain e tij, Hasanin, pra kemi lidhje të afërta familjare. Presidenti Clinton ka treguar një afërsi të jashtëzakonshme ndaj Kosovës dhe shqiptarëve. Megjithatë, unë besoj se edhe Kosova e ka ndihmuar atë në një mënyrë globale.

Siç e dimë nga librat dhe intervistat e tij, gjatë krizës në Bosnjë, pati hezitime për ndërhyrje. Por në Kosovë, shqiptarët nuk hezituan dhe i dhanë mbështetje të plotë. Ai vetë ka pranuar se ndjehet keq që nuk ka ndërhyrë më herët në Bosnjë, për të ndaluar tragjedinë atje.

Në një mënyrë ose tjetër, fati i Kosovës dhe vendimet e Clintonit janë ndërlidhur. Ne patëm fat që ai ishte President në momentin kritik për ne, dhe ai ndjehet fatlum që kishte mundësinë të bënte diçka të madhe për shqiptarët.

NJË MIQËSI E VEÇANTË ME SHQIPTARËT

Harry Bajraktari: Clinton ka një dashuri të sinqertë për shqiptarët, dhe këtë e ka treguar në shumë mënyra. Kujtoj pritjen madhështore që iu bë në Prishtinë, por edhe takimet e tij me shqiptarët në Amerikë.

E kam takuar disa herë këtu në SHBA, dhe kemi ruajtur kontakte të vazhdueshme. Kam qenë disa herë i ftuar në Shtëpinë e Bardhë, veçanërisht për festat e Krishtlindjeve.

Në vitin 1999, isha i ftuar në një nga këto evente dhe mora me vete vajzën time 12-vjeçare. Ishte një përvojë e mrekullueshme – jo vetëm për faktin që ishim në Shtëpinë e Bardhë, por për ndjenjën e respektit që Clinton kishte për komunitetin shqiptar.

Edhe Hillary Clinton ka pasur një marrëdhënie të veçantë me komunitetin shqiptar. Kur ajo kandidoi për Senatin në New York, e mbështetëm fuqishëm. Në vitin 2007, ajo erdhi në shtëpinë time, ku organizuam një mbledhje fondesh me kongresmenin Engel dhe shumë personalitete të tjera. Ishte një moment i paharrueshëm dhe një nder i madh për ne.

LIDHJA E PRESIDENTIT CLINTON ME KOMUNITETIN SHQIPTAR NË CHAPPAQUA

Presidenti Clinton jeton në një zonë ku restorantet më të njohura janë të shqiptarëve. Një nga pronarët e tyre është një djalë nga fshati im, i cili ka një restorant në atë zonë.

Clinton shkon shpesh atje, dhe një ditë fola me ata djemtë, Selman Ukajn dhe Mentor Berishën dhe iu thashë:

“Mos gaboni kurrë me i marrë pare Presidentit!”

Ata më thanë një zëri:

“Oh ja bre, as që bëhet fjalë me i pranue neve pare Presidentit Clinton.”

Ai është sinqerisht mirënjohës ndaj shqiptarëve dhe ndjehet i nderuar që ka qenë pjesë e historisë sonë. Ai e di që bëri për ne atë që nuk e bëri në Bosnjë, atë që nuk e bëri në Afrikë.

Dhe kjo e bën lidhjen e tij me shqiptarët të veçantë dhe të përjetshme.

Mal Berisha: *Nëse e analizojmë çështjen e Kosovës në kontekstin e ndërhyrjeve amerikane jashtë territorit të saj, mund të themi se ajo është ndoshta historia më e suksesshme e politikës së jashtme të SHBA-ve.*

Kjo, sepse pas luftës, Kosova jo vetëm që u çlirua, por u kthye në një shtet të lirë dhe të pavarur. Në shumë konflikte të tjera, luftërat mund të kenë përfunduar, por popujt nuk janë çliruar vërtet.

Shikojmë raste si Afganistani, Iraku dhe Siria – vende që kanë kërkuar shpenzime të mëdha, prani të gjatë ushtarake dhe humbje njerëzore nga ana e amerikanëve. Megjithatë, Kosova është një histori ndryshe.

- *Asnjë ushtar amerikan nuk është vrarë në Kosovë.*
- *Ndërhyrja ishte e shpejtë dhe efektive.*
- *Liria dhe pavarësia u arritën pa një okupim të gjatë ushtarak.*

Pra, është një histori e pastër suksesi. Dhe më e rëndësishmja, mirënjohja e shqiptarëve ndaj Presidentit Clinton dhe Amerikës mbetet e pashoqe.

E kemi të drejtën ta quajmë këtë një mirënjohje hyjnore, sidomos kur mendojmë për masakrën e Srebrenicës, ku tetë mijë njerëz u vranë brenda një dite, ndërsa trupat ndërkombëtare thjesht vëzhgonin dhe nuk ndërhynin.

Kjo e bën ndërhyrjen në Kosovë edhe më të rëndësishme dhe më të veçantë.

Harry Bajraktari: Është fenomenale. Populli shqiptar e ka parë Zoti. Por pavarësisht kësaj, ne duhet të punojmë më shumë për të forcuar pozitat tona në arenën ndërkombëtare.

Nëse e shikojmë historinë tonë moderne, Amerika ka ndërhyrë në dy momente vendimtare për shqiptarët:

Presidenti Woodrow Wilson, e shpëtoi Shqipërinë nga zhdukja pas Luftës së Parë Botërore. Presidenti Bill Clinton, gjithashtu e korrigjoi një padrejtësi historike, duke ndërhyrë në Kosovë pas një shekulli.

Këto dy momente kanë ndërtuar një lidhje të thellë midis shqiptarëve dhe Shteteve të Bashkuara. Dhe kjo lidhje duhet të ruhet dhe të forcohet më tej.

Mal Berisha: *Duke qenë se kam studiuar gjerësisht historinë e Presidentit Wilson dhe Konferencën e Paqes në Paris më 1919, dëshiroj të përmend një episod të rëndësishëm që shpesh nuk njihet sa duhet.*

Në atë kohë, ekzistonte një projekt për shpërbërjen e Shqipërisë. Ajo tashmë ishte reduktuar ndjeshëm në përmasa të vogla pas Konferencës së Ambasadorëve, por rrezikonte të copëtohej edhe më tej.

Sipas planeve të asaj kohe, Shqipëria do të ndahej si më poshtë:

- *Një pjesë Malit të Zi*
- *Një pjesë Serbisë*
- *Një pjesë Greqisë*
- *Një pjesë Italisë*

Në skenarin më ekstrem, do të mbetej vetëm një enklavë e vogël rreth Shijakut, si një territor me shumicë myslimane, pa ndonjë status të qartë politik.

Por, Presidenti Woodrow Wilson nuk e lejoi këtë. Ai u shpreh qartë dhe prerazi:

> *"Unë kam vetëm një zë në Konferencën e Paqes, dhe atë do ta përdor për shqiptarët."*

Falë vendosmërisë së tij, Shqipëria u shpëtua nga zhdukja dhe u ruajt si shtet më vete.

Harry Bajraktari: Një shekull më vonë, edhe ne ngulëm këmbë që Kosova të mbetej aty ku është sot. Shpesh, kur flas me kongresmanin Eliot Engel, kujtoj ngjarjet e atyre viteve dramatike. Për mua, ato janë të lidhura edhe me një dhimbje personale.

Në vitin 1998, babai im ndërroi jetë, dhe në atë kohë Kosova digjej nën sulmet serbe. Ishte një vit i tmerrshëm, plot tragjedi dhe pasiguri.

Në një nga fjalimet e tij, kongresmeni Engel e përmendi këtë moment dhe tha:

> *"Zotni Bajraktari, më vjen shumë keq që babai yt ka ndërruar jetë dhe ka vdekur me ixhramin (pengun) e Kosovës, por të jap besën që shpejt Kosova do të jetë e lirë."*

Në foto: Presidenti Ibrahim Rugova duke dalë nga Shtëpia e Bardhë, i përcjellë nga Sekretari i Sigurisë Kombëtare në administratën Clinton, Samuel "Sandy" Berger. Në sfond shihen anëtarë të delegacionit, i ndjeri Xhemajl Mustafa dhe z. Harry Bajraktari.

Dhe e mbajti fjalën. Vetëm një vit më vonë, në 1999, NATO ndërhyri dhe Kosova u çlirua.

Këto ngjarje tregojnë se historia përsëritet, por kur ka njerëz që ngulin këmbë dhe luftojnë për drejtësinë, ajo mund të shkruhet ndryshe. Ashtu si Wilson shpëtoi Shqipërinë në 1919, edhe miqtë tanë në Amerikë, pas një shekulli, shpëtuan Kosovën.

Mal Berisha: *Dhe ai e tha këtë fjalë në mortin e babait tuaj?*

Harry Bajraktari: Po, e tha në prill të vitit 1998. Dhe vetëm një vit më vonë, Kosova u çlirua. Dhjetë vjet më vonë, u shpall pavarësia.

Është e pabesueshme... në fakt, një mrekulli historike. E njëjta gjë vlen për Presidentin Clinton dhe Shtëpinë e Bardhë. Ne ishim këtu, ishim atje... gjithçka ishte një udhëtim politik dhe historik që lidhet ngushtë me Kosovën. Shumë liderë kanë luajtur rol kyç. Siç përmenda më parë, senatori Bob Dole, por edhe Tony Blair, i cili ishte fantastik në mbështetjen e Kosovës.

Unë mendoj se shumë prej këtyre liderëve e kanë ndjerë keqardhjen e madhe që nuk ndërhynë në Bosnjë. Por ne patëm fatin që Kosova nuk përjetoi atë që ndodhi atje. Nuk e lejuam historinë të përsëritej në të njëjtën mënyrë.

Mal Berisha: *Duke ndjekur zhvillimet e asaj kohe – dhe them me bindje se i kam ndjekur me vëmendje të madhe – mendoj se një nga veprimet më të mençura të Presidentit Ibrahim Rugova ishte qëndrimi i tij për të mos e futur Kosovën në luftë para kohe.*

Harry Bajraktari: Absolutisht po! Ishte një vizion i qartë dhe largpamës.

Mal Berisha: *Sepse, po të ishte bërë Kosova "kurbani i parë" përpara Bosnjës, ndoshta Bosnja do të kishte përfunduar si Kosova, por Kosova do të ishte bërë si Bosnja*.

Harry Bajraktari: Po të tregoj një moment shumë të rëndësishëm. Ishim në Washington, në të njëjtën kohë që ndodhej edhe Franjo Tuxhmani, presidenti i Kroacisë.

Tuxhmani bënte përpjekje të mëdha për t'u takuar me Rugovën, por ky i fundit nuk pranoi për dy ditë rresht. Amerikanët ushtruan shumë presion që ky takim të ndodhte. Pas shumë insistimesh, më në fund, u takuan.

Fjalët e para të Tuxhmanit ishin:

"Duhet të futeni në luftë. Armët do t'ua jap unë!"

Rugova qëndroi i heshtur, duke menduar thellë dhe duke pirë duhanin e tij.

Pas takimit, u kthyen në hotel. Aty ishim 5-6 vetë, të ulur afër tij, duke diskutuar mundësinë që Kroacia mund të na ndihmonte me armë për të filluar luftën.

Por, kur Rugova u kthye, ai tha diçka që na bëri të kuptonim largpamësinë e tij:

"Me ngadalë! Ky është bashkë me Milosheviçin. Interesi i tij është të na fusë në luftë, që ne të humbasim njerëzit tanë, të digjet dhe shkatërrohet vendi, ndërsa ai të përfitojë. Ai po përpiqet të na fusë në një kurth, ashtu siç futën Bosnjën. Ky është njësoj si Milosheviçi. Ai dëshiron që ne të vritemi, të digjemi e të shkatërrohemi, ndërsa ai të dalë fitimtar."

Dhe përfundoi:

"Ne nuk mund të hyjmë në luftë."

Në atë moment, aty ishte edhe Bujar Bukoshi. Ai e dëgjoi këtë vendim me shumë vëmendje. Ishte një moment kritik, sepse vendosi fatin e Kosovës në një periudhë shumë të rrezikshme.

Ky ishte vizioni i Rugovës. Ai nuk u nxitua, nuk ra në grackën e të tjerëve dhe i qëndroi besnik rrugës së tij për lirinë e Kosovës. Dhe historia e vërtetoi se ai kishte të drejtë.

Mal Berisha: *Zoti Bejtullah Destani po përgatit një botim të rëndësishëm që do t'ua sjellë lexuesve shqiptarë, amerikanë dhe anglezë – si dhe gjithë atyre që lexojnë në anglisht: Dokumentet e Presidentit Bill Clinton, të cilat hedhin dritë mbi rolin e tij në çështjen e Kosovës. Ju jeni njeriu që po mundëson botimin e këtij libri. A keni një mesazh për zotin Destani?*





Libri Presidenti W. J. Clinton – Lufta e Kosovës 1998–1999 është një punë shumë e vyer e historianit dhe diplomatit të njohur Bejtullah Destani, i cili është mbështetur në çdo aspekt nga z. Harry Bajraktari. Ky libër nuk është thjesht një dëshmi historike. Ai është një akt mirënjohjeje ndaj një presidenti amerikan që hyri në histori si shpëtimtar i kombit tonë të kërcënuar nga zhdukja.

Foto e Presidentit Bill Clinton, një prej figurave më të rëndësishme për ndërhyrjen ndërkombëtare në Kosovë gjatë viteve 1998–1999, i kujtuar me mirënjohje nga populli shqiptar për rolin e tij historik në mbrojtje të të drejtave dhe lirisë.

Harry Bajraktari: Para së gjithash, dua ta falënderoj nga zemra zotin Destani për punën e tij të palodhur. Ai ka realizuar shumë vepra të rëndësishme, të cilat kanë ndihmuar në zbardhjen e të vërtetave për çështjen shqiptare. Ju falënderoj edhe ju për mundësinë që më keni dhënë për të kontribuar në këtë projekt, i cili është një shërbim i çmuar për kombin tonë.

Ne, brenda mundësive tona, po përpiqemi të ndihmojmë dhe të veprojmë, duke ruajtur ndërgjegjen tonë kombëtare dhe përkushtimin për të dokumentuar të vërtetën.

Unë i uroj suksese zotit Destani dhe shpresoj që këto dokumente të përgatiten sa më shpejt. Ai më ka dërguar të gjitha informacionet, dhe unë i dërgova fondet sipas fjalës së dhënë

Për këtë, do t'ju njoftoj edhe ju. Dua që ju ta shikoni nga afër këtë proces,

në mënyrë që çdo gjë të bëhet me kujdes maksimal dhe të dalë në formën më të mirë të mundshme.

Pas kësaj, do të shqyrtojmë mundësi të tjera për projekte të ngjashme, që të kontribuojmë edhe më shumë.

Edhe një herë, e falënderoj zotin Destani për punën e tij të shkëlqyer, dhe ju falënderoj juve për mbështetjen dhe përkushtimin. Sepse, nëse dikush nuk merr përsipër një punë, ajo mbetet thjesht një ide e papërmbushur. Çdo arritje kërkon përkushtim, bashkëpunim dhe vullnet për ta çuar përpara.

Dhe unë jam i lumtur që jam pjesë e kësaj nisme dhe këtij botimi kaq serioz, që nderon kontributin e Presidentit Clinton për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës.

Mal Berisha: *Gjithë ky angazhim i jashtëzakonshëm i juaji dhe i shumë shqiptarëve që përmendët – puna me kongresmenë, senatorë, miq të Kosovës dhe të shqiptarisë, me administratën amerikane, me Këshillin e Sigurisë Kombëtare, sekretarë shteti dhe figura kyçe në Washington – e ka çuar çështjen e Kosovës aty ku është sot.*

Por a jemi sot në të njëjtën pozitë si dikur?

Kosova tashmë është e lirë dhe e pavarur, por a kemi ende detyrën për ta mbrojtur nga rreziqet që e kërcënojnë?

Përsëri, duket se Washingtoni mbetet aleati ynë më i madh, ai që do ta mbrojë Kosovën më shumë se kushdo tjetër. Edhe pse kemi miq të tjerë ndërkombëtarë, roli i Amerikës mbetet jetik.

Si e shihni ju situatën sot? A jemi ne, shqiptarët në Amerikë, ende po aq aktivë dhe të vendosur për ta ruajtur këtë histori suksesi dhe për ta çuar atë edhe më përpara?

A po bëjmë mjaftueshëm për ta mbajtur Kosovën në qendër të vëmendjes ndërkombëtare, ashtu siç bëmë dikur?

Harry Bajraktari: Unë druaj se sfidat për ne shqiptarët në Ballkan nuk do të marrin fund kurrë. Kemi përballuar shumë vështirësi historike dhe ende përballemi me sfida të reja.

Një nga problemet tona më të mëdha është mungesa e unitetit mes liderëve shqiptarë. Shpesh nuk arrijmë të bashkohemi dhe të ndjekim një strategji të përbashkët për çështjet kyçe kombëtare.

Në këtë drejtim, Shqipëria dhe liderët e saj mund të luajnë një rol shumë më konstruktiv. Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka kontakte të gjera dhe takon liderë të rëndësishëm në mbarë botën. Por kur ai propozon ndarjen e Kosovës, apo ide si Ballkani i Hapur, që e vendos Kosovën në të njëjtën strukturë me Serbinë, kjo shkakton shqetësime të mëdha.

Ne kemi mbi 100 vjet që përpiqemi të shkëputemi nga Serbia, dhe tani dikush na propozon të rikthehemi në të njëjtin rreth vicioz. Kjo jo vetëm që nuk ndihmon, por e bën edhe më të vështirë situatën në Kosovë dhe në gjithë rajonin.

PRESIONI I PADREJTË NDAJ KOSOVËS DHE DIPLOMACIA E BE-SË

Liderët e Kosovës, përveç sfidave të brendshme, përballen edhe me një qasje shpesh të padrejtë nga Bashkimi Evropian. Ka shtete si Spanja dhe Sllovakia, të cilat ende nuk e njohin pavarësinë e Kosovës, por dërgojnë diplomatë në misione "paqeruajtëse" në Kosovë. Si mund të besohet se këta diplomatë do të jenë të drejtë dhe të paanshëm, kur vendet e tyre as nuk e njohin Kosovën si shtet? Kjo është një hipokrizi e qartë. Dhe në këto rrethana, liderët tanë janë vënë në një pozitë shumë të vështirë. Kur dikush nga jashtë u thotë se duhet të veprojnë në një mënyrë të caktuar, por pa marrë parasysh interesat e Kosovës, atëherë kemi një problem serioz.

NDIKIMI GLOBAL DHE PASIGURIA E RAJONIT

Lufta në Ukrainë ka treguar se politikat globale mund të ndryshojnë nga dita në ditë, dhe askush nuk e di ende se si do të përfundojë kjo krizë.

Ndërkohë, Serbia vazhdon të luajë një lojë të rrezikshme, duke qëndruar në një pozicion të paqartë mes Lindjes dhe Perëndimit. Disa fuqi të

mëdha po përpiqen ta mbajnë dhe ta joshin Serbinë, dhe kjo është një sfidë e madhe për shqiptarët në rajon – në Kosovë, Mal të Zi dhe Maqedoninë e Veriut.

Ndërkohë, Shqipëria po shndërrohet gjithnjë e më shumë në një shtet njëpartiak. Ajo duhet të ketë një lidership që jo vetëm i mbron shqiptarët, por edhe i bashkon dhe i afron për të ndërtuar strategji të përbashkëta kombëtare.

MESAZHI PËR LIDERËT SHQIPTARË

Nuk është e lehtë t'ua shpjegosh në Washington se çfarë po ndodh në Kosovë dhe në rajon.

Ne kemi punuar për dekada të tëra për të krijuar miqësi dhe përkrahje. Por ndonjëherë, kur një lider shqiptar del dhe propozon ide që shkojnë kundër interesave kombëtare, ai dëmton punën tonë shumëvjeçare.

Unë ua kam thënë hapur dhe publikisht:

Nëse nuk mund të na ndihmoni, të paktën mos na dëmtoni! Na lini të qetë, sepse kemi luftuar për t'u shkëputur nga Serbia për më shumë se 100 vjet!

Të hapësh tema si ndryshimi i kufijve është shumë e rrezikshme. Po të fillohet me këtë, konfliktet në rajon mund të zgjasin edhe 100 vjet të tjera.

Në vitin 1999, kur NATO ndërhyri në Kosovë, i dha një urdhër të qartë Milosheviçit:

"Dil jashtë kufijve të Kosovës!"

Kur diskutoj në Departamentin e Shtetit, unë u shpjegoj qartë se këta ishin kufijtë që NATO mbrojti në vitin 1999. As Milosheviçi nuk i diskutoi, ai thjesht u tërhoq jashtë tyre.

Ndaj, kërkesa jonë është e thjeshtë:

Mos na ndryshoni kufijtë!

Mos na riktheni në një skenar të ri konflikti!

Kosova është shtet i pavarur dhe kufijtë e saj janë të paprekshëm.

Kjo është një vijë e kuqe që nuk duhet kaluar as nga ne, as nga ndërkombëtarët.

Mal Berisha: *Roli i shqiptarëve në Shtetet e Bashkuara duhet të rifitojë vrullin dhe ritmin që kishte dikur. Siç përmendët edhe ju, ka dy çështje të mëdha që janë jashtëzakonisht shqetësuese:*

1. Si mund të vendoset Kosova nën sanksione nga Bashkimi Evropian, kur ajo nuk i ka bërë askujt asnjë të keqe? Kosova është vendi i parë në Ballkan që ka zbatuar modelin e "diskriminimit pozitiv" për komunitetin serb, duke u dhënë atyre të drejta dhe privilegje që asnjë minoritet tjetër në rajon nuk i gëzon. Ata marrin ndihma dhe financime nga buxheti i Kosovës, ndërkohë që shumë prej tyre nuk kontribuojnë fare në të. Si mund të ndëshkohet Kosova për këtë?

2. Ish-udhëheqësit e UÇK-së, luftëtarët që sollën lirinë e Kosovës, janë marrë dhe janë dërguar në Hagë, për t'u gjykuar në një gjykatë speciale pa asnjë shqiptar – as prokuror, as gjykatës, as avokat. Kjo është një padrejtësi e papranueshme. Dhe, mbi të gjitha, i mbajnë për vite të tëra në paraburgim, pa asnjë vendim konkret, duke shkelur çdo normë humane dhe ligj ndërkombëtar.

Harry Bajraktari: Unë shpresoj se kjo administratë do të ndryshojë kursin dhe se SHBA do të rikonfirmojë mbështetjen e saj për Kosovën. Ne pritëm shumë nga administrata e Presidentit Biden, por fatkeqësisht, deri tani nuk ka bërë asgjë – jo vetëm për Amerikën, por edhe për pjesën tjetër të botës.

Amerikës i duhet një president i fortë, një lider që dërgon mesazhe të qarta dhe që ndërhyn kur duhet ndërhyrë. E kemi parë më parë se si ndonjëherë mjafton një mesazh i prerë për të bërë ndryshimin.

Për shembull, kur opozita në Venezuelë ishte e rrezikuar, Presidenti Trump bëri një postim të vetëm në Twitter, duke paralajmëruar që udhëheqësi i opozitës nuk duhej prekur. Brenda pak orësh, ata që

planifikonin eliminimin e tij u tërhoqën menjëherë. Kjo është fuqia e një lidershipi të qartë dhe të vendosur.

A ka sinjale pozitive për shqiptarët?

Edhe pse situata është e ndërlikuar, ka disa sinjale pozitive që mund të na ndihmojnë.

Shefi i CIA-s vjen nga Teksasi dhe është një mik i shqiptarëve. Sekretari i Mbrojtjes ka gjithashtu marrëdhënie të mira me komunitetin tonë. Sekretari i ri i Shtetit, Rubio, është një anti-komunist i bindur, dhe kjo mund të jetë një avantazh për ne.

Në një takim që pata me Michael Lawler, një figurë me ndikim në Westchester, diskutuam për rëndësinë e angazhimit të shqiptarëve në politikën amerikane. Ne e kemi ndihmuar në shumë aspekte dhe po punojmë që të kemi një ndikim edhe më të madh.

PSE DUHET TË ORGANIZOHEMI MË MIRË?

Ne duhet të kuptojmë diçka shumë të rëndësishme: politika në Amerikë funksionon me vota. Në zgjedhjet e fundit, ne siguruam rreth 2,000 vota për një kandidat, i cili fitoi me vetëm 800 vota diferencë. Pra, vota e shqiptarëve e bëri diferencën! Nëse vazhdojmë të organizohemi dhe të mobilizojmë komunitetin, ne mund të kemi një ndikim shumë më të madh në Washington.

Por sfida jonë më e madhe mbetet mungesa e unitetit. Do të ishte shumë e rëndësishme që VATRA të forcohej dhe të bëhej një platformë më e fuqishme për të ndikuar në çështjet tona kombëtare.

Unë u kam thënë disa prej drejtuesve të VATRËS:

Nëse dëshironi ta forcojmë VATRËN për 100 vitet e ardhshme, unë do të jem aty dhe do të ndihmoj. Por nëse synoni ta mbani për 2-3 vjet dhe pastaj ta lini, atëherë nuk kam kohë për diçka të tillë. Për fat të keq, shumë njerëz nuk kanë vizion afatgjatë, dhe kjo është një nga problemet kryesore.

Foto me vatranët, në ditën e promovimit të librit "HERMAN BERNSTEIN – Ambasador i Shteteve të Bashkuara në Mbretërinë Shqiptare", shkruar nga Mal Berisha. Në qendër ndodhet tashmë i ndjeri Inxhinier Agim Karagjozi. Në të majtë, ish-Kryetari i Vatrës, z. Dritan Mishta, dhe në krah të tij, z. Harry Bajraktari. Në anën tjetër, aktivisti i njohur vatran, z. Sergio Bitici, ndërsa në sfond shihen një numër aktivistësh të tjerë, ndër të cilët edhe drejtori i gazetës Dielli, tashmë i ndjeri z. Dalip Greca.

SHEMBUJ POZITIVË NGA KOMUNITETI SHQIPTAR NË SHBA

Ka disa komunitete shqiptare që kanë arritur të mobilizohen dhe të bëjnë diferencën:

- Në Teksas, shqiptarët kanë ndërtuar një rrjet të fortë dhe kanë krijuar kontakte të rëndësishme.
- Në Michigan, shqiptarët kanë ndihmuar kandidatët e duhur të fitojnë.
- Xhovalin Gega dhe grupi i tij kanë mbledhur vota dhe kanë ndikuar drejtpërdrejt në rezultatet e zgjedhjeve.

Kjo tregon se kur veprojmë së bashku, mund të kemi një ndikim të jashtëzakonshëm.

MESAZHI IM PËR TË GJITHË SHQIPTARËT:

Mos e hapni çështjen e ndarjes së Kosovës! Ajo është një vijë e kuqe që nuk duhet kaluar. Nuk mund të lejojmë që dikush tjetër të vendosë për kufijtë tanë! Ne duhet të vazhdojmë të forcojmë rolin e komunitetit shqiptar në SHBA, sepse Washingtoni mbetet faktori kyç për të ardhmen e Kosovës dhe të gjithë shqiptarëve në rajon.

E kemi treguar më parë se kur jemi të bashkuar, mund të bëjmë mrekulli.

Tani është koha që të bëjmë edhe më shumë.

Mal Berisha: *Zoti Bajraktari, ju falënderoj nga zemra për këtë bisedë kaq të pasur dhe frymëzuese! Kontributi juaj i jashtëzakonshëm për çështjen kombëtare shqiptare, lidhjet e forta që keni ndërtuar me politikanët më të rëndësishëm amerikanë dhe përkushtimi juaj i palodhur për të mirën e Kosovës dhe shqiptarëve janë një shembull i rrallë i atdhedashurisë së vërtetë. Ju keni qenë dhe mbeteni një nga figurat kyçe të lobimit shqiptar në Amerikë. Historia e angazhimit tuaj dhe e gjithë shqiptarëve të Amerikës është një histori suksesi, e cila duhet të vazhdojë edhe më tej.*

Faleminderit për këtë rrëfim të jashtëzakonshëm!

Harry Bajraktari: I dashur z Berisha! Ishte një kënaqësi e veçantë të zhvillonim këtë bisedë së bashku! Më vjen mirë që patëm mundësinë të ndanim këto kujtime, sfida dhe arritje që kanë shënuar rrugëtimin tonë për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës. Ky është një mision që nuk përfundon këtu, ndaj shpresoj që edhe brezat e rinj të vazhdojnë ta mbajnë gjallë këtë përpjekje.

Faleminderit për këtë bisedë të mrekullueshme!


I dashur zotni
Harry Bajraktari!
Nëse ky titull i këtij libri:
"MALET E GJIGANTËVE"
i shkon për shtat dikujt nga
Gegënia jonë heroike,
Juve dhe familjes Tuaj do
të ishit ndër të parët.
Me respekt nga:
Mal Berisha
New York – 12-12-2024

I dashur zotni Harry Bajraktari!
Nëse ky titull I këtij libri: Malet e Gjigantëve" i shkon për shtat dikujt nga Gegënia jonë heroike, Juve dhe familjes Tuaj do të ishit ndër të parët.
Me respekt, Mal Berisha 17 dhjetor 2024, New York

Foto me shqiptaro-amerikanë të shquar në Newark, New Jersey, gjatë festës së njohjes së Kërcimit të Tropojës si pasuri e trashëgimisë botërore nga UNESCO, si dhe promovimit të librit "Malet e Gjigantëve". Në foto: Violeta Berisha, kryetare e Bashkisë Englewood, NJ; z. Harry Bajraktari; znj. Laura Rexhaj dhe bashkëshorti i saj, z. Agim Rexhaj – President i Nderit i Federatës Pan-Shqiptare të Amerikës "Vatra". Në radhën e dytë, i pari majtas: Fadil Berisha, artist dhe fotograf i njohur shqiptaro-amerikan.

Miqësia me z. Harry Bajraktari shkon përtej një njohjeje personale
— ajo është diçka shumë më e thellë dhe më e vlefshme.
Në foto: Erion dhe Kreuza me z. Bajraktari.

Nderimi për ideatorin, themeluesin, realizuesin dhe njohjen e shtetit të pavarur – Republikën e Kosovës, ka qenë dhe mbetet një detyrim moral, shoqëror, kombëtar dhe patriotik i përhershëm. Miq si Kongresmeni Eliot Engel i janë bashkuar këtij nderimi edhe përpara memorialit të Presidentit Ibrahim Rugova, në shoqërinë e z. Harry Bajraktari dhe të biznesmenit të njohur, filantropit Rrustem Geci.

PËRMBYLLJE:

Ky material është një homazh nderi për kontributin e një bashkëatdhetari dhe një frymëzim për mbarë bashkësinë shqiptare, kudo në botë, e në mënyrë të veçantë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, për të kuptuar se sa e madhe është forca jonë kur besojmë në idealet tona kombëtare dhe i ndjekim ato deri në përmbushjen e tyre.

FUND

★ ★ ★

KY MATERIAL ËSHTË NJË HOMAZH
NDERI PËR KONTRIBUTIN E NJË
BASHKËATDHETARI DHE NJË FRYMËZIM
PËR MBARË BASHKËSINË SHQIPTARE,
KUDO NË BOTË, E NË MËNYRË TË
VEÇANTË NË SHTETET E BASHKUARA
TË AMERIKËS, PËR TË KUPTUAR SE SA
E MADHE ËSHTË FORCA JONË KUR
BESOJMË NË IDEALET TONA KOMBËTARE
DHE I NDJEKIM ATO DERI NË
PËRMBUSHJEN E TYRE.

★ ★ ★